

## **B. LITERATURË E SYGJERUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT**

Librat e poshtëshënuara japin një informatë themelore mbi sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe burimet e tij. Ato janë mjaft të vlefshme si një informatë bazë për çdonjërin që është i interesuar mbi të drejtat e njeriut dhe në veçanti janë të rëndësishme për edukatorët e të drejtave të njeriut. Po ashtu, ofrojnë njohuri fillestare dhe informata për hulumtim të mëtejshëm.

**Titulli: Udhëzues i të drejtave të njeriut, institutet, standardet, procedurat**

Autori/Editori: Januz Simonides, Vladimir Volodin

Vendi i botimit: Francë

Botuesi: UNESCO

Viti i botimit: 2001

Përmbajtja: Ky botim jep një informatë të shkurtër mbi instrumentet kryesore të të drejtave të njeriut; procedurat dhe mekanizmat për mbrojtje të të drejtave të njeriut; ndodhitë primare dhe institucionet që merren me çështje të të drejtave të njeriut. Është i disenjuar për ata që janë të interesuar për të drejtat e njeriut, së pari për edukatorët, për nxënësit, aktivistët e të drejtave të njeriut dhe profesionistët e mediave.

**Titulli: Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut**

Autori/Editori: Hanski Raji / Suksi Markku (edu.)

Vendi i botimit: Turku / Abu

Botuesi: Abo Academy University: Instituti për të Drejtat e Njeriut

Viti i botimit: 1999, Botimi i dytë

ISBN: 952-12-0247-5

Përmbajtja: Libri ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme dhe në të njëjtën kohë të kuptueshme për mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Është një hyrje që përshkruan sistemin dhe standardet kryesore dhe, në të vërtetë, është munduar të plotësohet me më shumë studime të specializuara. Libri do të ishte me interes të veçantë për studentët, por mund të përdoret po ashtu në kurse të veçanta të të drejtave të njeriut, nga praktikuesit, nga punëtorët e OJQ dhe aktivistët si dhe nga të gjithë ata që janë të interesuar për të drejtat e njeriut.

**Titulli: Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Tekst mësimor, Botimi i dytë i plotësuar**

Autori/Editori: Ajsborn Eide, Katarina Kraus, Allen Rosas

Vendi i botimit: Drodrecht; Botston; London

Botuesi: Martinus Nijhoff

Viti i botimit: 2001

ISBN: 90-411-1595-1

Përmbajtja: ky libër është një tekst mësimor gjithëpërfshirës mbi të drejtat e njohura ndërkombëtarisht, ekonomike, sociale dhe kulturore. Përqendrohet në këto kategori por po ashtu analizon lidhjen me të drejtat civile dhe politike. Ky botim i dytë përfshin kapituj mbi realizimin vendor të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

**Titulli: Strategji efektive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; Sanksionet ekonomike, përdorimi i gjykatave kombëtare dhe mekanizmat ndërkombëtare për kontrollin e fuqisë**

Autori/Editori: David Barnhizer (ed.)

Vendi i botimit: Dartmouth

Botuesi: Ashgate

Viti i botimit: 2001

Përmbajtja: Ky tekst sjell së bashku përvojat dhe diapazonin e ndryshëm të avokatëve dhe aktivistëve kryesorë të të drejtave të njeriut, që t'i demonstronë strategjitë e tyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Libri identifikon problemet dhe qasjet dhe ofron një numër strategjish për sanksionimin e shkelësve të të drejtave të njeriut për frenimin e sjelljeve, të cilët mundën të përfshihen në veprime të tilla. Kontribues të këtij libri janë Noam Chomsky, Gjykatësi Riçard Goldstone dhe Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore, si dhe David Raouf, Ambasador i SHBA në Ruandë gjatë ndodhjes së gjenocidit tragjik.

Titulli: Të drejtat e njeriut: Koncepte dhe standarde.

Autori/Editori: Janusz Symonides (ed.)

Vendi i botimit: Aldershot

Botuesi: Dartmouth Publishing Company Limited

Viti i botimit: 2000

ISBN: 92-3-103589-4

Përmbajtja: Ky vëllim prezenton refletimet mbi prespektivat historike dhe themelet filozofike të të drejtave të njeriut. Ofron analiza të detajuara të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe të drejtat e personave që u përkasin grupeve të cenuara, si femrat, fëmijët, minoritetet, banorët vendës dhe punëtorët emigrantë, si dhe ndërveprimi në mes të ligjit humanitar dhe të drejtave të njeriut.

**Titulli: Të drejtat e njeriut: Dimensione të reja dhe sfida. Doracak mbi të drejtat e njeriut.**

Autori/Editori: Janusz Symonides

Vendi i botimit: Brookfield (ao)

Botuesi: UNESCO, Ashgate

Viti i botimit: 1998

ISBN: 1 84014 426 2

Përmbajtja: Ky libër prezenton ndërmarrëdhëniet dhe ndërvarjen në mes të të drejtave të njeriut dhe paqes, demokracisë, zhvillimit dhe ambientit. Ajo analizon pengest dhe kërcënimet për të drejtat e njeriut dhe sygjeron mejtet që t'i tejkalojmë ato, diskuton ndikimin pozitiv dhe negativ të globalizmit, revulucionit informativ dhe progresit shkencor dhe teknologjik në të drejtat e njeriut.

**Titulli: Të Drejtat e Njeriut: pyetje dhe përgjigje**

Autori/Editori: Leah Levin

Vendi i botimit: Paris

Botuesi: UNESCO

Viti i botimit: 1996

ISBN: 92-3-103261-5

Përmbajtja: ky libër ofron informata themelore mbi instrumentet më të larta të të drejtave të njeriut, procedurat e zbatimit dhe veprimet e organizatave ndërkombëtare në mënyrë që t'i promovojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e njeriut. Ky libër është mjaft i përdorueshëm

për studentët dhe mësuesit dhe për të gjithë ata të cilët janë të kyçur apo të interesuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

**Titulli: Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut: Metoda dhe Efektshmëria**

Autori/Editori: Frances Butler

Vendi i botimit: Kluwer

Botuesi: The Hague

Viti i botimit: 2002

ISBN: 90-411-1702-4

Përmbajtja: Ky libër hulumton mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe gjerësinë në të cilën ata funksionojnë në praktikë. Ka shumë fakte se mbrojtja e të drejtave të njeriut është e rëndësishme se kurrë më parë dhe ky libër shqyrton se çka është më me rëndësi për arritjen e kësaj me efektivitet.

**Titulli: Doracaku Adresues i të Drejtave të Njeriut**

Autori/Editori: Theo R.G. van Banning, Williem J.M. van Genugten

Vendi i botimit: Holandë

Botuesi: Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Qeverisjes së Mirë dhe Demokratizimit

Viti i botimit: 1999

Përmbajtja: Ky libër ka për qëllim që të zhvillojë një politikë më të koherente dhe më të qëndrueshme për të drejtat e njeriut, që në të ardhmen një kontribut më i madh në lidhje me të drejtat e njeriut mund të bëhet në të gjithë botën.

Gjendet në dispozicion në faqen e internetit:

<http://www.minbuza.nl>

**Titulli: Standardet e të Drejtave të Njeriut dhe Përgjegjësia e Koorporatave në Tranzicion**

Autori/Editori: Michael K. Addo

Vendi i botimit: Hagë

Botuesi: Kluwer Law International

Viti i botimit: 1999

Përmbajtja: Ky libër adreson pyetje të tilla si: cila është natyra dhe sfera e përgjegjësisë së korporatave në lidhje me të drejtat e njeriut? A duhen kompanitë në mes tyre të jenë të përgjegjshme për shkeljen e të drejtave të njeriut duke përfshirë këtu vetveten apo ndihmësit e tyre? Cilat parime duhet të udhëheqin biznesin në vendet të cilat njihen për shkeljet e të drejtave të njeriut? A është vetë rregullimi efikas apo korporatat duhet të rregullohen me kode nacionale apo ndërkombëtare, dhe në çka duhet të bazohen këto kode?

**Titulli: Të drejtat e njeriut sot. Letrat përmbledhëse të KB**

Autori/Editori: Kombet e Bashkuara

Vendi i botimit: New York

Botuesi: Botim i Kombeve të Bashkuara

Viti i botimit: 1998

ISBN: 92-1-100797-6

Përmbajtja: Kjo përmbledhje radhit hapa konkret të cilët janë ndërmarrë nga nivelet nacionale dhe ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara që t'i forcojnë programet e të drejtave të njeriut dhe të punojnë me efikasitet më të madh me partnerët e tyre në qeverisjen e shoqërisë civile dhe t'i sigurojnë të drejtat e njeriut për të gjithë. Veç kësaj ajo ofron një plan për punë.

**Titulli: Enciklopedia ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, lirive, abuzimeve dhe shpërdorimeve**

Autori/Editori: Robert L. Maddex

Vendi i botimit: Uashington D.C.

Botuesi: CQ Press

Viti i botimit: 2000

ISBN: 1-56802-490-8

Përmbajtja: Një adresim i ilustruar përshkruar i koncepteve dhe termave, marrëveshjeve, njerëzve dhe organizatave që ndihmojnë për garantimin e të drejtave të njeriut përreth botës.

**Titulli: Manual mbi Raportimin e të Drejtave të Njeriut**

Autori/Editori: Kombet e Bashkuara

Vendi i botimit: Gjenevë

Botuesi: Botime të Komeve të Bashkuara

Viti i botimit: 1997

ISBN: 92-1-100752-6

Përmbajtja: Qëllimi kryesor i këtij manuali është që të shërbejë si vegël praktike për zyrtarët qeveritar në përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve të kërkuara nga traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara.

**Titulli: Të drejtat e njeriut në kontekstin ndërkombëtar: E drejta, politika, morali**

Autori/Editori: Henry J. Steiner; Philipp Alston

Vendi i botimit: Oksford

Botuesi: Botime të Universiteti të Oksfordit

Viti i botimit: 2000

ISBN: 0-19-829849-8

Përmbajtja: Ky libër trajnim ofron një mori materialesh primare dhe sekondare të edituara me kujdes së bashku më një tekst të gjerë, komente editoriale, dhe pyetje për studim. Mbulon një numër të gjerë të temave të të drejtave të njeriut siç janë: karakteristikat themelore të ligjit ndërkombëtar, evoluimi i lëvizjes për të drejtat e njeriut; të drejtat civile, politika dhe sociale; ligji ndërkombëtar humanitar; globalizmi; vetëvendosje; të drejtat e femrave; zbatimi dhe fuqizimi.

**Titulli: Regjimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut**

Autori/Editori: Manfred Nowak

Botuesi: Kluwer Law Publishers

Viti i botimit: 2003

Përmbajtja: Ky tekst shkollor ofron një hyrje të shkurtër por të hollësishme për idenë dhe doktrinën e të drejtave të njeriut si dhe strukturën, mekanizmat dhe sfidat momentale për sistemin ndërkombëtar të mbrojtjes së drejtave të njeriut.

**Titulli: Tekst Shkollor mbi të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut**

Autori/Editori: Rhona K.M Smith

Botuesi: Shtypi Univesitar i Oksfordit

Viti i botimit: 2003

Përmbajtja: Ky libër shkollor ofron hyrjen themelore në historikun e të drejtave të njeriut, standardet rajonale dhe universale dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut si dhe një numër të të drejtave substanciale si barazia, mosdiskriminimi, e drejta për jetë, dhe të drejtat e pakicave (minoriteteve).

**Titulli: Raporti i PZHKB (UNDP)**

Autori/Editori: Kombet e Bashkuara

Vendi i botimit: New York, Oksford

Botuesi: Botime të Kombeve të Bashkuara, Shtypi Universitar i Oksfordit

Viti i botimit: 2000

Përmbajtja: Raporti i zhvillimit njerëzor i PZHKB, i cili del për çdo vit, është një burim i mirë i ofrimit të informatave mbi çështjet e zhvillimit në kontekst të gjerë. Raporti i PZHKB nga viti 2000 shikon të drejtat e njeriut si një pjesë e brendshme e zhvillimit dhe e zhvillimit si mjet i realizimit të të drejtave të njeriut.

**Titulli: Deklaratat Universale e të Drejtave të Njeriut ne Teori dhe Praktike**

Autori/Editori: Jack Donnelly

Vendi i botimit: Ithaca, London

Botuesi: Botim i Universiteti të Cornell-it

Viti i botimit: 2003, Botimi II

Përmbajtja: Jack Donnelly Elbaorono mbi teorinë e të drejtave të njeriut, i adreson argumentet e relativizmit kulturor, dhe hulumton efikasitetin e veprimeve bilaterale dhe multilaterale. Një kapitull krejtësisht i ri adreson çështjet me rëndësi pas luftës së ftohtë përfshirë këtu intervenimin humanitar, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, “vlerat aziatike”, të drejtat e grupit, dhe diskriminimin kundër pakicave seksuale.